URDHËR
Nr. 477, datë 26.6.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Oltjon Muzaka, zëvendësministër, për zbatimin e aktiviteteve, lidhur me ndjekjen dhe zbatimin e Marrëveshjes së Grantit nr. 2582/7 prot., datë 11.6.2026, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për përgatitjen e programit "Për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore në Shqipëri".

2. Programi përgatitor "Për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore në Shqipëri", përfshin menaxhimin financiar dhe prokurimin, specifikisht:

a) Të ngrejë komisionin për hartimin e termave të referencës;

b) Të ngrejë komisionin e vlerësimit të shprehjeve të interesit/ofertave;

c) Të miratojë raportin e vlerësimit të shprehjeve të interesit/ofertave;

ç) Të emërojë negociatorin dhe koordinatorin e kontratës;

d) Të nënshkruajë kontratën me subjektin e përzgjedhur fitues;

dh) Të autorizojë për ekzekutimin e pagesave përkatëse;

e) Çdo dokument në funksion të realizimit të plotë të aktiviteteve.

3. Delegimi i kompetencës mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri z. Oltjon Muzaka, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala